

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6853  
E hënë, 20 mars 2023  
çmimi 0.40

Më 2 prill "Liria ka emër"  
organizon marsh  
në mbështetje të  
ish-krerëve të UÇK-së Faqë 6



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
 [facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



## REAGIME TË SHUMTA NDAJ KURTIT PËR MARRËVESHJEN E ARRITUR ME VUÇIQIN NË OHËR

# OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE: KURTI PRANOI MARRËVESHJE PA NJOHJE, ME ASOCIACION DHE AUTONOMI PËR PAKICËN SERBE Faqë 4



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, janë takuar më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut në kuadër të procesit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve dhe pas 10 orë bisedimesh kanë arritur

marrëveshje për zbatimin e propozimit evropian. Megjithatë, atë nuk e nënshkruan zyrtarisht. Ndaj kësaj marrëveshjeje kanë reaguar partitë opozitare, PDK-ja dhe LDK-ja dhe shoqëria civile, duke theksuar se kryeministri Kurti ka pranuar një marrëveshje pa

njohje reciproke, e përqendruar në një asociacion të avancuar e autonomi politike për komunitetin serb dhe pa garanci për integrimin euroatlantik të Kosovës. Ndërkëq PSD-ja, e drejtuar nga Dardan Molliqaj, ka thirrur protestë për këtë të shtunë

## MAVRAJ: JO RETORIKAVE PROPAGANDUESE, ZOTIMI GOJOR DALLON NGA ZOTIMI ME NËNSHKRIM, NUK KA NJOHJE



**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xheqisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
[info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigmapro.net](http://www.sigmapro.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

BANKA ZVICERANE UBS BESOHET  
TË JETË NË BISEDIME PËR TA  
BLERË RIVALEN "CREDIT SUISSE" F. 2

INCIDENTI ME DRON NXJERR  
NË DUKJE RREZIKUN  
E KONFRONTIMIT SHBA - RUSI F. 8

LIMAJ KËRKON DORËHEQJEN E  
KURTIT: SHKELI KUSHTETUTËN F. 3

PDK-ja PËRKRAH MARSHIN NË  
MBËSHTETJE TË ISH-KRERËVE TË  
UÇK-së F. 6



PASURIA E KOSOVËS NË DUART  
E FONDIT SOVRAN F. 7



GABOJNË BALLKANI DHE DRITA,  
FITON PRISHTINA F. 10

## Banka zvicerane UBS besohet të jetë në bisedime për ta blerë rivalen "Credit Suisse"

**BERN, 19 MARS** - Banka më e madhe e Zvicrës, UBS, raportohet se është në bisedime intensive për të blerë plotësisht, apo pjesërisht, bankën rivale "Credit Suisse" e cila së fundi po përballet me telash financiare. Vlera e aksioneve të "Credit Suisse" ka rënë ndjeshëm ditët e fundit, pasi është thënë të jetë gjetur "deficit" në raportet financiare.

Një injekzion financier urgjent prej 54 miliardë dollarëve nga Banka Kombëtare Zvicerane nuk duket se ka zgjidhur problemin. Rregullatorët janë duke tentuar të ndërmjetësojnë një marrëveshje para se tregjet e aksioneve të

rihapen sërisht të hënën. Ka shqetësimë se aksioneve të "Credit Suisse" mund t'u bjerë edhe më shumë vlera. Ky situatë ka shtuar brengat për krizë më të madhe financiare.

Qeveria zvicerane e ka mbajtur të shtunën një takim urgjent, mirëpo nuk është bërë e ditur se çfarë është diskutuar aty. Agjencia e lajmeve "Reuters" ka raportuar se UBS besohet t'i ketë kërkuar Qeverisë zvicerane që ta ndihmojë me 6 miliardë dollarë nëse vendos ta blejë bankën "Credit Suisse". Secila marrëveshje e ngjashme mund të rezultojë me humbje të shumë vendeve të punës. Ky

problem koincidon me falimentimin e dy bankave në Shtetet e Bashkuara - "Silicon Valley Bank" dhe "Signature Bank" - duke rritur shqetësimet për gjendjen e sistemit bankar.

"Credit Suisse" njihet si bankë globale e investimeve dhe menaxhon assetet e klientëve shumë të pasur. Ajo është një prej 30 bankave në botë që konsiderohen tejet të mëdha për të dështuar, sepse janë të një rendësie të madhe për sistemin bankar ndërkombëtar. Në fund të vitit të kaluar "Credit Suisse" ka pasur një staf prej 50 480 punëtorësh, përfshirë 16 700 në Zvicër.



## OBSh-ja i kërkon Kinës t'i publikojë të gjitha të dhënat e lidhura me origjinën e Covid-it

**GJENEVË, 19 MARS** - Këshilltarët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh-së) i kanë bërë thirrje Kinës t'i publikojë të gjitha informacionet e lidhura me origjinën e pandemisë Covid-19, pas disa gjetjeve të reja që u zbuluan bazuar në gjurmimin e patogenjëve.

Analizimi i ri i virusit SARS-CoV-2, por edhe të dhënat e reja të gjenomit, që janë marrë nga tregu i kafshëve në Wuhan të Kinës më 2020, për një kohë të shkurtër u publikuan në databazën GISAID nga shkencëtarët kinezë gjatë këtij viti, duke i lejuar hulumtuesit nga shtetet e tjera t'i analizojnë, tha grupi i këshilltarëve shkencorë për origjinën e patogenjëve në OBSh, i njohur me shkurtesën SAGO.

Analizimi i këtyre të dhënavëve sugjeroi se rakunët që ishin në tregun e Vuhanit mund të jenë infektuar me koronavirus, duke ofruar të dhëna të reja lidhur me zinxhirin e transmetimit të virusit, që në fund preku edhe njerëzit. Por, qasja në këto informacione ishte e kufizuar, "që ka të ngjarë të bëhen përditësimë të reja të



dhënavë" nga Qendra kinezë për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve.

Zyrtarët e OBSh-së kanë diskutuar për këtë çështje me homologët e tyre kinezë, të cilët shpjeguan se të dhënat e reja synohej që të përditësonin një studim të publikuar më 2022. Qendra kinezë ka thënë se planifikon që ta ripublikojë studimin në gazetën shkencore "Nature".

Zyrtarët e OBSh-së thanë se

informacione të tillë paraqesin një qasje të re për hetimin e origjinës së koronavirusit dhe këruan që këto informacione të ndahen menjëherë me ta. "Këto të dhëna nuk ofrojnë një përgjigje definitive të pyetjes se si filloj pandemia, por çdo e dhënë është e rëndësishme për t'iu afuar së vërtetës", tha drejtori i OBSh-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus. "Këto të dhëna mund të ishin ndarë me ne tre vjet më parë", tha ai

më 17 mars. "Ne vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Kinës që të jetë transparente në ndarjen e të dhënavëve dhe t'i kryejë hetimet e nevojshme dhe më pas t'i ndajë rezultatet e tyre".

SAGO është deleguar nga OBSh-ja që ta vazhdojë hetimin e origjinës së pandemisë që ka vrarë pothuajse 7 milionë persona në mbarë botën.

Tregu i kafshëve dhe ushqimeve të detit në Wuhan ishte mbyllur nga autoritetet kinezë pas

shfaqjes së rasteve të para me koronavirus në fund të vitit 2019. Që atëherë ky treg ka qenë në fokus të studimeve nëse virusi kishte infektuar disa specie para se të transmetohej te njerëzit.

OBSh-ja dhe shkencëtarët e tjera kanë thënë se ende nuk mund ta përjashtojnë mundësinë që virusi të ketë dalë nga një laboratori i sigurisë së lartë në Wuhan, që studion patogenjet e rrezikshëm. Kina mohon se kjo ka ndodhur.

Më 2022 u publikua një studim, pas analizimit të 923 mostra të mbledhura nga sistemet e kanalizimit dhe tezgat e tregut, ato kishin dalë pozitivë me koronavirus. Ndërkëq, në 457 kafshët e testuara asnjëra nuk kishte rezultuar pozitive. Në këtë studim thuhej se rakunët nuk ishin në mesin e kafshëve të testuara.

Analizat e reja sugjerojnë se "rakunët dhe kafshët e tjera mund të kenë qenë në këtë treg para se ai të pastrohet nga autoritetet si pjesë e përpjekjeve për ta rritur sigurinë shëndetësore publike", tha SAGO përmes një deklarate.

## Të paktën 15 persona të vdekur nga tërmeti në Ekuador

**ELORO, 19 MARS** - Të paktën 15 persona kanë vdekur dhe më shumë se 400 janë plagosur si pasojë e një tërmeti 6.7 shkallë të Rihterit që e ka goditur gjirin jugor të Ekuadorit.

Është raportuar se ndërtuesat janë dëmtuar në disa qytete.

Provinca jugore ElOro është prekur më së keqi dhe, sipas autoritetetve, 12 persona kanë vdekur aty.

Presidenti Guillermo Lasso u ka bërë thirrje ekuadorianëve që ta ruajnë qetësinë derisa zyrtarët i vlerësojnë dëmet. Ai,

po ashtu, e ka vizituar një spital në qytetin Maçala për të takuar disa të lënduar. Ky është tërmeti më i fuqishëm që e ka goditur Ekuadorin prej vitit 2016, kur gati 700 njerëz kanë vdekur dhe mijëra të tjerë janë plagosur.



# Mavraj: Jo retorikave propaganduese, zotimi gojor dallon nga zotimi me nënshkrim, nuk ka njohje

**PRISHTINË, 19 MARS** - Publicisti Muhamet Mavraj ka folur për takimin e së shtunës në Ohër ndërmjet kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, pas të cilit u arrit marrëveshje përzbatimin e propozimit evropian, por pa vënë nënshkrime në të si dy shtete.

Mavraj ka shkruar në "Facebook" se zotimi gojor ka peshë, por është diçka tjetër nga nënshkrimi i dokumenteve. Ai ka theksuar se duhet t'u thuhet jo e kthjellët retorikave propagandistike, sidomos për çështjen e qershive të harxhuara tashmë. "Serbia po i mbetet besnikë udhëzimit të kahershëm të Kishës që të mos prodhojë fakte të nënshkruara (dokumente) sa i përket Kosovës. Nuk kishte, nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë lëvizje juridike ndaj Kosovës pa nënshkrim shtetëror. Efekte psikologjike e politike ka, në rajon dhe në Evropë. Çfarëdo që thuhet përtej këtij realiteti është mashtrim i radhës", ka shkruar Mavraj.

Ai ka shtuar se njohja e llojit de facto nuk bëhet tinëz, bëhet me nënshkrim dhe shprehimisht. "Njohja e llojit de jure, gjithashtu, sidomos te vendet ndërluftuese, nuk bëhet tinëz, por shprehimisht e nënshkruar dhe kurrë nuk mund të tèrhiqet", ka shkruar publicisti Mavraj.

Ai ka theksuar se Serbia manovroi me fjalë dhe shmangu fajësinë e fitoi çfarë do ta shohim se fitoi. "Një dekadë e humbëm kot. Gjepurat me patriotizëm fals rëndë i kushtuan Kosovës. Dekada në vijim fare lehtë mund të humbet kot. Kot i kërkjmë fajtorët nëpër botë. Zvarritjet e Kosovës ishin dhe janë ujë i mullirit ruso-serb", ka shkruar Mavraj.

## Postimi i plotë i Mavrjt:

Sapo përfundoi takimi i Ohrit. Zotimi gojor ka peshë, por është

diçka tjetër nga nënshkrimi i dokumenteve.

Dialogu, bisedimet, takimet janë më të mira sesa izolimet ose konfliktet e dhunshme. Kurdoherë. Kosova ishte gjithmonë pro tyre, pavarësisht dhunës në rrugët e Prishtinës. Diçka lëviz përpëra, diçka zbutet nga të biseduarit. Por, duhet t'u thuhet jo e kthjellët retorikave PROPAGANDISTIKE, sidomos për çështjen e qershive të harxhuara tashmë.

E dimë takatin tonë (Kosovës) dhe i njohim e i kuptojmë aktorët e faktorët në lojë, kontekstet gjeopolitike etj. E dimë edhe që po spastrohet etnikisht Kosova e po rëndohet kurrizi i shtetasve në varfërim e sipër. E dimë edhe peshën e rëndë të veprimeve politike të viteve të fundit.

Serbia po i mbetet besnikë udhëzimit të kahershëm të Kishës që të mos prodhojë fakte të nënshkruara (dokumente) sa i përket Kosovës. Nuk kishte, nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë lëvizje juridike ndaj Kosovës pa nënshkrim shtetëror. Efekte psikologjike e politike ka, në rajon dhe në Evropë. Çfarëdo që thuhet përtej këtij realiteti është mashtrim i radhës.

Deri më tani vetëm në Uashington ka nënshkruar Serbia, ndonëse jo në të njëjtin dokument me nënshkrim tonë. E dimë peshën e një nënshkrimi në Shtëpinë e Bardhë.

Mos të harrojë askush: njohja e llojit DE FACTO nuk bëhet tinëz, bëhet me nënshkrim dhe shprehimisht. Ajo është e tërheqshme në çdo kohë. Ka plot shembuj. Meqenëse është e tërheqshme, do të na njihte më herët Serbia, çdo mëngjes. Por, ajo nuk prezikon të prodhoje as t'u lë trashëgim të vetëve fakte të nënshkruara për Kosovën shtet jashtë saj.

Njohja e llojit DE JURE, gjithashtu, sidomos te vendet ndërluftuese, nuk bëhet tinëz,

 Muhamet Mavraj  
6h · 

Dua ta lexoj veten edhe pas shume vjetesh, ndaj e di cfare them para jush. Te mos e humbasim vemendjen nga interesimi kryesor, ai juridik, duke u kushtuar kohe te humbur grindjeve me rendesi dytesore a periferike pas marreveshjes gojore te Ohrit. Postimi pas Ohrit ketu fton per te gjykuar me kthjellet per Kosoven, per disa koncepte kyçe juridike-politike, sepse aty manipulojne lehte te interesuarit. Per ndonje hezitues a medyshes, qe po e citon pa hezitim e pa medyshje kryetarin serb, por pjeserisht, per te me demantuar, ja pika kryesore qe po e anashkalojne: "Vuçiq tregon pse nuk firmosi asgjë në Ohër: Nuk bëj marrëveshje juridike ndërkombëtare me Republikën e Kosovës". (<https://www.epokaere.com/vuciq-tregon-pse-nuk-firmosi.../>)

Dhe, ky tjetri, mbreme:  
"Albin Kurti: BE-ja të gjjejë mekanizëm për ta bërë marrëveshjen ligjërisht të detyrueshme, pasi Serbia refuzoi nëshkrimin" (<https://www.epokaere.com/albin-kurti-be-ja-te-gjeje.../>)  
Por, sot, si perhere, propaganda zyrtare me disa cope deputetësh po mundohen ta thone te kunderten. Ndoshta u vjen keq një dite, ndonëse keqardhja nuk i zhben momentet e shkelura historike.  
Mos u deshperoni, miq! Ka Kosova potenciale per me mire!



por shprehimisht e nënshkruar dhe kurrë nuk mund të tèrhiqet. Ajo e ndryshon sistemin juridik të vendit njohës në raport me shtetin e njohur de jure (ligjërisht). Ky është rendi ndërkombëtar.

Serbia manovroi me fjalë dhe shmangu fajësinë e fitoi çfarë do ta shohim se fitoi.

Një dekadë e humbëm kot.

Gjepurat me patriotizëm fals rëndë i kushtuan Kosovës. Dekada në vijim fare lehtë mund të humbet kot. Kot i kërkjmë fajtorët nëpër botë. Zvarritjet e Kosovës ishin dhe janë ujë i mullirit ruso-serb.

Ky nuk është tekst për pesimizëm. Është sqarues. Dialogu me ndërmjetësim evropian, përfat të keq, mbetet

vetëm meremetim i ngrirjes së konfliktit për kohët e përshtatshme nëse ato i vijnë sërisht palës gjenocidare. Prandaj nuk nënshkruan as nuk ratifikon asnjë gjë asnjëherë.

(Të drejtën e botimit ia jap "Epokës së re". Miqtë janë të lirë ta komentojnë këtu ose shpërndajnë profilet e tyre)

## Limaj kërkon dorëheqjen e Kurtit: Shkeli Kushtetutën

**PRISHTINË, 19 MARS** - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka reaguar pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të shtunën janë pajtuar për normalizimin e raporteve në Ohër.

Limaj i ka kërkuar kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, që të jepë dorëheqje pasi, sipas tij, ai ka humbur legjimitetin. "Ke humbur legjimitetin, jep dorëheqje Albin! Saktësish katër ditë pa mbushur dy vjet prej kur mori drejtimin e qeverisë, Albin Kurti do të mbahet mend dhe përgjegjës përfishimin e barrës së

obligimeve të shtetit të Kosovës", ka theksuar Limaj.

Ai thotë se Kurti për dy vjet mashtroi qytetarët me politika populiste. "Ujdia e arritur mbrëmë është rezultat i politikave mashtruese e populiste dyvjeçare. Për më tepër, kjo marrëveshje është edhe ndëshkim për qasjen e tij përkëtë proces", ka vijuar Limaj. I pari i Nismës thotë se Kosova pos që nuk mori njohje përfundoi edhe në marrëveshje me "Zajednicë" brenda. "Kryeministri ka shkelur Kushtetutën e vendit dhe duhet të dorëhiqet menjëherë", ka deklaruar Limaj.





REAGIME TË SHUMTA NDAJ KURTIT PËR MARRËVESHJEN E ARRITUR ME VUÇIQIN NË OHËR

## Opozita dhe shoqëria civile: Kurti pranoi marrëveshje pa njohje, me asociacion dhe autonomi për pakicën serbe

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, janë takuar më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut në kuadër të procesit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve dhe pas 10 orë bisedimesh kanë arritur marrëveshje për zbatimin e propozimit evropian. Megjithatë, atë nuk e nënshkruan zyrtarisht. Ndaj kësaj marrëveshjeje kanë reaguar partitë opositare, PDK-ja dhe LDK-ja dhe shoqëria civile, duke theksuar se kryeministri Kurti ka pranuar një marrëveshje pa njohje reciproke, e përqendruar në një asociacion të avancuar e autonomi politike për komunitetin serb dhe pa garanci për integrimin euroatlantik të Kosovës. Ndërkaq PSD-ja, e drejtuar nga Dardan Molliqaj, ka thirr protestë për këtë të shtunë

e saj sa më shpejt që të jetë e mundur.

Partitë opositare në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e kanë kritikuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për arritjen e pajtueshmërisë me presidentin serb, Aleksandar Vuçiç, për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të marrëdhënieve mes tyre, të mbështetur nga Bashkimi Evropian.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë përmes një postimi në "Facebook" se kryeministri Kurti "pranoi gjithçka që kishte premtuar se nuk do të pranonte, përgjatë tërë jetës së tij politike me predikime të rrejshme e mashtrime të panumërtë". "Por, përtëj mashtrimeve të tij, brengë ynë mbetet Kosova, qytetarët tanë dhe brezat e ardhshëm, të cilët, fatkeqësisht, përvëçse e kanë humbur besimin në perspektivën që

ofron Kosova, do ta trashëgojnë për vite me radhë konfliktin e ngrirë me Serbinë. Dhe kjo është pasojë direkte e gabimeve të Albin Kurtit që ka negociuar dhe mundësuar këtë marrëveshje që është e pamjaftueshme për Kosovën dhe që nuk i arrin qëllimet tona shtetërore e qytetare", ka thënë Krasniqi.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixiku, ka shkruar, po në "Facebook", se epilogu i kryeministrit Kurti, si kryeministër në dialog, është "mashtrim dhe humbje e një mundësie historike". "Një kauzë politike e rremë - që Kosovës i kushtoi tmerrësisht shumë - përfundoi sonte. Kushtet e vëna, fjalimet e thëna, qëndrimet e dhëna, thjesht u zhbenë", ka thënë ai.

Të dy e kanë përmendur edhe çështjen e njohjes reciproke, e përqendruar në një asociacion të avancuar e autonomi politike për komunitetin serb dhe pa garanci për integrimin euroatlantik të Kosovës, është dështim i madh politik e kombëtar, të cilin do ta paguajmë shtrenjtë dhe gjatë, të

takimit në mes të Kurtit dhe Vuçiç atë ditë - nuk e obligon Serbinë që ta njohë Kosovën, por kërkon nga të dyja vendet t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomatë dhe targat. Ajo kërkon, po ashtu, nga palët që t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin Qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rezikojë funksionalitetin e shtetit.

Krasniqi ka thënë se "marrëveshja pa njohje reciproke, e përqendruar në një asociacion të avancuar e autonomi politike për komunitetin serb dhe pa garanci për integrimin euroatlantik të Kosovës, është dështim i madh politik e kombëtar, të cilin do ta paguajmë shtrenjtë dhe gjatë, të

**Mal QORRAJ**

EPOKA  
ERE

**PRISHTINË, 19 MARS** - Kosova dhe Serbia janë pajtuar më 18 mars në Ohër, që ta fillojnë zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e raporteve sa më shpejt që të jetë e mundur. Megjithatë, atë nuk e nënshkruan zyrtarisht. Kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borell, ka thënë se edhe pse palët kanë vendosur të mos e nënshkruajnë zyrtarisht marrëveshjen, ato janë pajtuar ta fillojnë zbatimin

gjithë".

Lidhur me këtë temë, Abdixhiku beson se Kurti i ka siguruar Kosovës "një marrëveshje pa njohje, jo finale dhe me asociacion plus në të".

Vetë Kurti ka thënë, pas takimit të 18 marsit, se pajtimi i arritur në Ohër është "njohje e ndërsjellë de facto" e Kosovës dhe Serbisë.

I pyetur nga gazetarët nëse do ta lejojë formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ai tha se bëhet fjalë për "një nivel adekuat të vetëmenaxhimit të komunitetit serb" dhe "jo për vetëqeverisje". Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka theksuar se Kosova e fitoi luftën ndaj Serbisë e kryeministri Kurti e dështoi Kosovën në tavolinë historikisht dhe strategjisht. Sipas saj, Kurti pranoi marrëveshjen pa njohje me Serbinë, me asociacion dhe autonomi për pakicën serbe. "Kuvendi i Kosovës dhe deputetët duhet ta bëjnë korrigjin e këtij dështimi historik duke mos miratuar këtë marrëveshje; të mos lejojnë këtë kapitullim të Kosovës përballë Serbisë, por ta jetësojnë kapitullimin e Serbisë në Kumanovë më 1999, të cilën e arritëm me luftën, gjakun dhe diplomacinë e mençur të shqiptarëve", ka thënë Tahiri.

Profesori universitar, Valon Murati, ka thënë se u arrit pajtueshmëri për marrëveshje që nuk zgjidh problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, me këtë marrëveshje reciprociteti u harrrua e Kosova Lindore dhe shqiptarët atje u injoruan. Murati ka thënë se kjo marrëveshje rrrezikon funksionalitetin e brendshëm të Kosovës.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka theksuar se marrëveshja e arritur në Ohër është e dëmshme për Kosovën. "Kurti nuk ka mandat për këtë marrëveshje. Mashtrimi është i madh dhe i rrezikshëm për demokracinë dhe qytetarinë", ka thënë Molliqaj. Ai i ka ftuar të gjithë ata qytetarë që janë kundër marrëveshjes dhe kundër mashtrimit t'i bashkëngjiten protestës së thirrur për të shtunën në orën 14:00 në sheshin "Zahir Pajaziti". Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, shpreson që arritura e marrëveshjes së panënskruar Kosovë - Serbi të mos jetë tjetër mashtrim ballkanik. "Le të shpresojmë që djalli të mos fshihet në detaje sonte dhe që marrëveshja e rënë dakord, por e panënskruar, të mos jetë një tjetër mashtrim ballkanik! Përndryshe kjo do të ishte një arritje historike që do të shpalte një pranverë të shumëpritur në marrëdhënie mes dy kombeve më të mëdha të Ballkanit", ka shkruar Rama në "Twitter".

### Kurti: Kjo marrëveshje është njohje de facto

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se marrëveshja e arritur në Ohër të Maqedonisë së Veriut është "njohje de facto", por shtoi se presidenti i Serbisë,

Aleksandar Vuçiç, po i ikën nënshkrimit të marrëveshjes. Kurti tha se i takon Bashkimit Evropian që ta gjejë mekanizmin që ta bëjë këtë marrëveshje ndërkombëtare ligjërisht të obligueshme. "Marrëveshja bazë është njohje e ndërsjellë de facto. Pra, kjo është njohje de facto ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", tha Kurti. Pas raundit të bisedimeve, Kurti tha se pajtimi publik është arritur për aneksin e zbatimit të propozimit evropian për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ne erdhëm në Ohër për ta nënshkruar marrëveshjen bazë, me një aneks. Pala tjetër, njëjtë si në takimin e kaluar [takimi në Bruksel më 27 shkurt], po i ikën nënshkrimit të marrëveshjes", tha Kurti.

I pyetur rrëth deklarimit të shefit të lartë të BE-së, Josep Borrell, se ky pajtim parashev nisjen e shpejtë të procesit të krijimit të një mekanizmi të vetëmenaxhimit të komunitetit serb në Kosovë, kryeministri Kurti nuk mohoi një gjë të tillë, por tha se kjo do të bëhet duke u bazuar në standartet më të larta. "Nuk është vetëmenaxhim", tha kryeministri Kurti kur iu përgjigj pyetjes nëse do të formohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. "Ekziston një paragraf i cili flet për një nivel adekuat të vetëmenaxhimit të komunitetit joshumicë serb dhe natyrisht se ne do të udhëhiqemi prej standardeve më të larta që edhe serbët në Kosovë të mos kenë asnjë cени, asnjë diskriminim", shtoi ai.

Kurti tha se kjo marrëveshje e arritur në Ohër "është më e mira e mundshme në këto rrethana për Kosovën, për raportet e Kosovës me Serbinë. Ai tha se aneksi do të publikohet nga Bashkimi Evropian. "Unë mendoj se është platformë solide për të ecur përpëra, andaj është e pranueshme për ne", tha Kurti.

### Vuçiç: Nuk nënshkruam asgjë, por patëm njëfarë marrëveshje

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, pas takimeve të gjata në Ohër, njoftoi se nuk kanë nënshkruar asgjë, por se kanë arritur "njëfarë marrëveshje". Në një deklarim para medieve, Vuçiç u shpreh i lumtur për këtë, ndërsa ka thënë se për Serbinë është shumë me rëndësi formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Kemi arritur njëfarë marrëveshje. Unë jam i lumtur për këtë. Por kjo nuk është e tëra. Për ne është shumë e rëndësishme që formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe [në Kosovë] është vendosur si detyrim me prioritet dhe atë në përputhje me marrëveshjet e arritura më parë në kuadër të dialogut. Më duhet të them se jam shumë i kënaqur për këtë", ka deklaruar Vuçiç në Ohër. Sipas tij, fillimisht do të formohet një komision i përbashkët

# Aneksi i zbatimit të marrëveshjes, drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi

*Bashkimi Evropian publikoi tekstin e aneksit për zbatimin e propozimit evropian, pasi liderët e Kosovës dhe Serbisë u pajtuan për të gjatë takimeve të zhvilluara në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars.*

- Aneksi është një pjesë integrale e Marrëveshjes.
- Kosova dhe Serbia angazhohen plotësisht për t'i respektuar të gjitha nenet e Marrëveshjes dhe këtë Aneks, dhe për t'i zbatuar të gjitha detyrimet e tyre përkatëse - që rrjedhin nga Marrëveshja dhe Aneksi - në mënyrë të përshtatshme dhe në mënyrë të mirëbesim.
- Palët e kanë parasysh se Marrëveshja dhe Aneksi i zbatimit bëhen pjesë integrale e proceseve përkatëse të anëtarësimit të Kosovës dhe Serbisë në BE. Palët e kanë parasysh se, menjëherë pas miratimit të Marrëveshjes dhe këtij Aneksi, ndërmjetësuesi i BE-së do të fillojë procesin për t'i ndryshuar standartet e Kapitullit 35 për Serbinë, për t'i konsideruar detyrimet e reja të Serbisë, që rrjedhin nga Marrëveshja dhe Aneksi.
- Palët pajtohen për të miratuar Deklaratën për Personat e Zhdukur, siç është negociuar në
- Kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, si çështje urgjente.
- Për të zbatuar Nenin 7, Kosova nis menjëherë negociatat në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, për përcaktimin e aranzhimeve dhe garancive specifike, që sigurojnë një nivel të duhur të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, në përputhje me marrëveshjet e mëparshme përkatëse të dialogut, siç përcaktohet nga ndërmjetësuesi i BE-së.
- Palët bien dakord për të krijuar një Komitet të Përbashkët Monitorues, të kryesuar nga BE-ja, brenda 30 ditësh. Zbatimi i të gjitha dispozitatve do të sigurohet dhe mbikëqyret nga Komiteti i Përbashkët Monitorues.
- Për të zbatuar Nenin 9, BE-ja do të organizojë një konferencë donatorësh brenda 150 ditësh, për të krijuar një paketë proceset e tyre përkatëse të anëtarësimit në BE dhe për ndihmën financiare që marrin nga BE-ja.

Maqedonisë së Veriut, në të cilin Escobari mori pjesë në cilësinë e vëzhguesit, ai tha se arritura e pajtimit për zbatimin e propozimit evropian mundëson që Kosova dhe Serbia të ecin drejt integrimeve euroatlantike. "Dua t'i uroj palët për arritjen e një marrëveshjeje të vështirë, por të nevojshme për të arritur një marrëdhënie paqësore dhe të parashikueshme midis tyre. Kjo jo vetëm që hap derën për integrime më të mëdha euroatlantike për të dyja shtetet, por hap derën edhe për rajonin për të hyrë në një epokë të re të paqes", tha ai.

Kur u pyet se pse liderët e

Serbinë. Asnjë shpërndarje nuk do të ndodhë përpëra se BE-ja të përcaktojë se të gjitha dispozitat e Marrëveshjes janë zbatuar plotësisht.

- Kosova dhe Serbia pajtohen që të gjitha nenet të zbatohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Rendi i paragrafëve të këtij Aneksi nuk e paragjykon rendin e zbatimit të tyre.

- Kosova dhe Serbia pajtohen që të mos e bllokjnë zbatimin e asnjë prej neneve.

- Të gjitha diskutimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes do të zhvillohen në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja.

- Kosova dhe Serbia pranojnë se mosrespektimi i obligimeve të tyre nga Marrëveshja, Aneksi ose Marrëveshjet e Dialogut të kaluar, mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta negative për proceset e tyre përkatëse të anëtarësimit në BE dhe për ndihmën financiare që marrin nga BE-ja.

Kosovës dhe Serbisë nuk e nënshkruan marrëveshjen, Escobari tha se i beson mekanizmit të Bashkimit Evropian për zbatimin e aneksit të propozimit evropian për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "U jam falenderues partnerëve tanë evropianë që na sollën në këtë pikë dhe jam mirënjohës edhe ndaj dy liderëve që kishin guximin politik për të arritur atë që arritin sone", tha Escobar. Marrëveshjen e kanë vlerësuar lajm të mirë shumë përfaqësues ndërkombëtarë dhe diplomatë të huaj.



## Më 2 prill "Liria ka emër" organizon marsh në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 MARS** - Platforma "Liria ka emër" do të organizojë një marsh për drejtësi në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. Në njoftim thuhet se ky marsh do të mbahet më 2 prill në Prishtinë. Marshi do të niset nga sheshi "Zahir Pajaziti" dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit "Skënderbeu".

Ideatorët e platformës "Liria ka emër", Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë thënë se ish-krerët e UÇK-së nuk janë duke u përballur me procesin gjyqësor për shkak të emrave të tyre të pérveçëm, por për shkak se me emrat e tyre lidhet epoka më e ndritur e historisë sonë të re. "Përkundër se populli shqiptar ka qenë viktimi e një lufte të imponuar, me vite të tëra, proceset gjyqësore të pabaza, i kanë përndjekur ndër vite ishpjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kulmi i të cilave manifestohet me procesin e Dhomave të Specializuara, në të cilat aktualisht po mbahen ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarë të tjere", ka thënë Eliza Hoxha.

Më tej, ajo ka shtuar se duke qenë plotësisht koshientë se drejtësia si



parim eshtë e paanshme, e plotë dhe manifeston të vërtetën, ajo beson në drejtësi, si dhe pret një epilog të drejtë të këtij procesi gjyqësor. "Gjithsesi, duhet të jemi edhe koshientë, se përpjekja për ta ndryshuar historinë e luftës sonë çlirimtare eshtë përpjekje e pabazë dhe e pamundur dhe ne nuk duhet ta lejojmë që të ndodhë. Prandaj, me rastin e fillimit të procesit

gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së, në emër të solidaritetit me heronjtë tanë, më 2 prill ju ftojmë për një marsh solidarizimi për drejtësi. Për drejtësinë që e kërkojmë dhe kundër padrejtësive të reja", ka thënë Hoxha.

Ideatori tjetër, Ismail Tasholli, ka thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë të drejtë për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe

përlirinë e vendit tonë dhe kjo eshtë një e vërtetë historike të cilën duhet ta ruajmë si të tillë, sepse e vërteta e gjithsecilit prej nesh eshtë e vërteta e Kosovës. "Megjithatë, përbrenda vetë nesh e kemi për obligim që të vërtetën historike e dinjitetin tonë kombëtar ta mbrojmë me përkushtim dhe pikërisht për këtë qëllim", ka thënë Tasholli.

PDK-ja përkrah marshin në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se partia që drejtton dhe ai e mbështetin marshin për drejtësi të ftuar nga iniciativa "Liria ka emër", në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së të cilët po mbahen në Hagë.

Ai i ka ftuar qytetarët e Kosovës t'i bashkohen këtij marshi solidarizues për ta shprehur hapur mbështetjen dhe bindjen e palëkundur mbi pastërtinë dhe drejtësinë e luftës tonë çlirimtare. "Liria dhe pavarsia e Kosovës qëndrojnë mbi përpjekjen shekullore të popullit tonë dhe sakrifisë sublime të dëshmorëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo e vërtetë historike eshtë e vërteta e Kosovës. Janë nderi dhe krenaria jonë kombëtare. Sot eshtë obligim dhe detyrë e jona qytetare e patriotike që këtë të vërtetë ta mbrojmë nga çdo tendencë për tjetësim", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

## Vazhdon vendosja e kamerave në shkolla, komuna e Prishtinës s'ka raporte për efektet e tyre



**PRISHTINË, 19 MARS** - Komuna e Prishtinës ka filluar vendosjen e kamerave të sigurisë edhe nëpër shkollat dhe çerdhet në fshatrat e kësaj komune në tentim për ta zvogëluar dhunën dhe rastet e tjera penale nëpër këto institucione.

Plani përvendosjen e kamerave të sigurisë nëpër shkollat dhe çerdhet në kryeqytet ka filluar që në dhjetor të vitit 2022 dhe komuna e Prishtinës tashmë ka kaluar edhe në fshatra.

Së fundmi, kamerat janë vendosur edhe në shkollën "Ali Kelmendi" në Barilevë me qëllim që nxënësit të ndihen të sigurt në ambientet e shkollës.

Drejtoresha e Arsimit në Prishtinë, Besiane Musmurati, ka theksuar për "KosovaPress" se vendosja e kamerave po bëhet pasi rastet e dhunës në shkolla duhet të zvogëlohen. Ajo ka treguar se

kamerat janë vendosur në hapësirat ku lejohet me ligj, por ka nënvisuar se ende nuk kanë statistika të qarta nëse kamerat e vendosura po kontribuojnë në parandalimin e rrahjeve dhe kacafytjet e nxënësve nëpër shkolla.

Drejtoresha e Shkollës Filllore e Mesme e Ulët "Ali Kelmendi" në fshatin Barilevë, Bedrie Pireva, ka thënë për "KosovaPress" se që nga vendosja e kamerave të sigurisë në shkolla nuk kanë hasur as bullizëm, por as shkelje të të drejtave të fëmijëve, pasi tanimë ata e dinë që janë nën vëzhgimin e kamerave.

Sipas drejtoreshës së Arsimit në Prishtinë, Besiana Musmurati, komuna e Prishtinës deri në fund të mandatit ka synim të përfundojë vendosjen e kamerave në të gjitha shkollat në kryeqytet.

## Themelohet nëndege e PDK-së në Goppingen të Baden-Wurttembergut

**PRISHTINË, 19 MARS** - Deputeti i PDK-së, Elmi Reçica, së bashku me kryetaren e Degës së PDK-së në Baden-Wurttemberg, Lindita Zeqiri dhe me bashkëpunëtorë, morëm pjesë në Kuvendin Zgjedhor të Nëndege së PDK-së në Goppingen, me ç'rast kryetari i kësaj nëndege u zgjodh politologu i shqar, doktoranti i Universitetit të Stuttgartit, Leon Duhanaj dhe, po ashtu, kryesia e

kësaj nëndege në përbërje prej 12 anëtarëve.

Tubimin themelues e përshtendet kryetari i Shoqatës Kulturore "Nëna Terezë" në Goppingen, Jahja Gashi, një aktivist i shqar dhe punëtor i madh i mbajtjes gjallë i aktivitetit kulturor dhe artistik shqiptar në mërgatë, kryetari i Degës së PDK-së në Malishevë, Mevludin Mazreku dhe përfaqësuesi i

strukturave të PDK-së nga Dega e Bajernit dhe Thuringenit, Mentor Mazreku.

Në këtë takim të pranishëm ishin bashkëveprimtarë, intelektualë të shqar, aktivistë të çështjes kombëtare, struktura të PDK-së në Gjermani dhe biznesmenë të suksesshëm, të cilët i janë bashkuar vizionit të PDK-së për t'ia kthyer Kosovës dinjitetin dhe qeverisjen e mirë.



# Pasuria e Kosovës në duart e Fondit Sovran



Hotel Grand në Prishtinë. Fotografi nga arkivi.

**PRISHTINË, 19 MARS** - Fondi Sovran mund të ndikojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe rezultatet e para pritet të shihen pas pesë vjetësh, thotë për Radion Evropa e Lirë ish-drejtori menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ekrem Hajdari.

Eksperti i çështjeve ekonomike dhe ish-ministri i Financave, Haki Shatri, thotë se ky fond synon që shteti të bëhet pronar i ndërmarrjeve ekonomike.

Fondit Sovranit pritet t'i bartet pasuria më e rëndësishme publike e Kosovës.

Kjo ka nisur të rregullohet përmes një Projektligji për Fondin Sovran, i cili u publikua më 13 mars dhe deri më 2 prill do të jetë në konsultim publik. Pas konsultimeve procedohet përmiratim në qeveri dhe më pas në Kuvendin e Kosovës.

Projektligji e definon Fondin Sovran si institucion investues dhe zhvillimor të Kosovës. Kapitali themeltar i Fondit Sovran, siç thuhet në projektligji, është 20 milionë euro dhe mbulohet nga Qeveria e Kosovës.

Përmes administrimit të ndërmarrjeve dhe aseteve të Kosovës, Fondi Sovran synon "zhvillimin e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve".

Në projektligji thuhet se Fondi Sovran do ta menaxhojë pasurinë e rëndësishme të Kosovës duke rritur vlerën, performancën dhe kthimin në investimet që do të bëhen. Në

këtë pasuri, me të cilën do të menaxhojë Fondi Sovran, hyjnë ndërmarrjet publike të shtetit, ndërmarrjet shoqërore dhe asete të cilat aktualisht menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Sipas vlerësimeve të grupit punues të Projektligjit për Fondin Sovran disa nga ndërmarrjet publike, të cilat janë identifikuar se mund t'i barten Fondit Sovran, janë: Korporata Energetike e Kosovës, Telekom i Kosovës, Posta e Kosovës, Kombinati metalurgjik Trepça, Trainkosi dhe Infrakosi.

Fondit Sovran do t'i barten nga Agjencia Kosovare e Privatizimit edhe disa ndërmarrje shoqërore dhe asete. Sipas AKP-së, me potencial ekonomik të lartë janë 94 asete dhe rrëth 48 mijë hektarë tokë që mund t'i barten Fondit Sovran.

Nëntëdhjetë e katër asetet përfshijnë: miniera, ndërtesa administrative e lokale, fabrika, hotele, ferma, depo të ndryshme, pika të karburanteve, qendra rehabilituese, zyra, toka bujqësore të të gjitha kategorive e të tjera.

Fondi Sovran, sipas projektligjit, po ashtu ka në funksion edhe themelin e ndërmarrjeve të reja si dhe mund të investojë në tregje financiare dhe tregje të kapitalit brenda dhe jashtë vendit.

## Çfarë thonë ekspertët?

Ish-drejtori menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ekrem Hajdari,

thotë për Radion Evropa e Lirë se projektligi i Fondit Sovran është kualitativ dhe mund të ofrojë mundësi të një zhvillimi ekonomik në vend.

Megjithatë, burimet e financimit të propozuara në projektligj janë pakta, thotë Hajdari. "Gjëja më e rëndësishme në këtë drejtëmbet financimi i nevojshëm për funksionalizmin e këtyre asteve në dobi të një interesit të dobishëm financier dhe zhvillimor në vend. Njëzet milionë euro për fillimin e punës së fondit nuk janë të mjaftueshme. Me ato mjete as Hotel Grandin nuk mund ta vësh në funksion e lërë më asete tjera: si miniera, apo projekte turistike si Brezovica", thotë Hajdari.

Hajdari thotë se, përvèç të tjerash, në projektligj paraqitet nevoja edhe për një projeksjon të quartë të rezultateve ekonomike dhe zhvillimore që pritet t'i japë fondi për një periudhë pesëvjeçare. "Personat përgjegjës që do të udhëheqin me këtë fond nëse e kanë një plan konkret dhe projeksjone konkrete në terma financiarë, do të jenë më të fokusuar në rritjen e atyre rezultateve", thotë Hajdari.

Rezultatet e para Fondi Sovran, sipas Hajdarit, mund t'i ketë pas pesë deri shtatë vjetësh.

Kosova, thotë profesori i Ekonomisë, Safet Gërxhalii, ka nevojë për reformë ekonomike, por për të pasur rezultate të dëshirueshme duhet të ketë stabilitet politik si dhe sundim

të rendit dhe ligjit në Kosovë. "Me këtë projektligj që është bërë, nuk kemi arsyë përfundim. Është utopike të mendohet se Fondi Sovran nuk mund të ketë efekte në zhvillim ekonomik në aspektin kohor afatshkurtër", thotë Gërxhalii.

## Fondit i barten vetëm asetet me potencial zhvillimor

Projektligji ka përcaktuar edhe disa kushte të bartjes së aseteve në pronësi të Fondit. Përfundimisht, Fondit Sovran, njëra nga kushtet që përcaktuan projektligj, është që aseti duhet të jetë i komercializueshëm dhe të premtojë fitim brenda një periudhë të arsyeshme.

Ndërkohë, nëse është ndërmarrje, duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe plan biznesi të quartës.

Sa i përket potencialit të ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tjera, Hajdari, thotë se disa prej tyre, siç është qendra e skijimit Brezovica, minierat, "Grand Hoteli" kanë një potencial të madh në zhvillimin e përgjithshëm industrial, tregtarie dhe turistik.

## Premtim elektoral

Krijimi i Fondit Sovran ka qenë premtim elektoral i partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje. Ky premtim pas marrjes së

pushtetit është futur edhe në programin qeverisës katervjeçar.

Qeveria me krijimin e Fondit Sovran ka paraparë shuarjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes së cilës janë privatizuar 2.315 asete, në vlerë prej më shumë se 780 milionë eurosh.

Për ekspertin e çështjeve ekonomike dhe ish-ministrin e Financave, Haki Shatri, Qeveria e Kosovës me këtë fond po synon të fusë në sistemin ekonomik shtetin, duke e bërë pronar të ndërmarrjeve ekonomike.

Kjo formë e ekonomisë, sipas Shattrit, nuk i përgjigjet zhvillimit të një vendi. "Çdo gjë që nuk është në pajtim me ekonominë e tregut të lirë nuk sjell rezultate. Këto eksperimente ku shteti qeverisë me pasurinë e saj, nuk funksionon. Nuk mendoj që dikush mund të menaxhojë në mënyrë efikase me paratë që nuk i ka të vetat", thotë Shatri.

Kosova vazhdon të ketë probleme të mëdha ekonomike - me një rritje ekonomike mesatare vjetore prej 4-përqindësh, e cila nuk e adreson problemin e papunësisë që e kalon 20 përqindëshin. Kosova gjatë dy vjetëve të fundit është goditur edhe nga inflacioni i lartë. Viti i kaluar është mbyllur me normë mesatare të inflacionit qatë 12 përqindëshin.

# Incidenti me dron nxjerr në dukje rrezikun e konfrontimit ShBA - Rusi



Activité Wind

**UASHINGTON, 19 MARS** - Prej se ka nisur lufta në Ukrainë në shkurt të vitit të kaluar, zyrtarët amerikanë kanë paralajmëruar se rreziku i konfrontimit midis Rúsise dhe ShBA-së është një mundësi. Dhe më 14 mars kontakti i parë fizik i ushtrive të tyre ka ndodhur. Një avion luftarak rus ka goditur një dron vëzhgues të ShBA-së mbi Detin e Zi, duke sulumuar helikën e tij dhe duke bërë që operatorët e tij amerikanë ta rrëzojnë atë në ujërat ndërkombëtare.

Incidenti ka rritur menjëherë tensionet mes Shtëpisë së Bardhë dhe Kremlinit, pasi zyrtarët amerikanë i kanë akuzuar forcat e përfshira ruse për "sjellje të rrezikshme".

Shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë amerikane, gjenerali Mark Milley, ka thënë se ndjekja e dronit pa pilot, i cili ka qenë në mision të zakonshëm vëzhgues në hapësirën ndërkombëtare ajrore, ka qenë "e qëllimshme", por ka theksuar se ky akt nuk duhet të çojë në luftë me Rusinë. "Sapo të ndodhë një akt lufte, unë nuk do të shkoj atje. Incidentet ndodhin. Dhe, qartazi, ne nuk duam konflikt të armatosur me Rusinë. Ne duhet ta hetojmë këtë incident dhe të lëvizim përpara. Por, do të vazhdojmë t'i ushtrojmë të drejtat tona në hapësirën ajrore ndërkombëtare", ka thënë Milley.

Ministria ruse e Mbrotjes ka pretenduar se droni amerikan po shkonte drejt territorit të kontrolluar nga Rusia dhe ka thënë se ai është rrëzuar vetë. Sipas saj, nuk ka pasur asnjë sulm.

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka thënë se Rusia i ka shpallur disa zona të Detit të Zi të

ndaluara për trafik ajror gjatë konfliktit në Ukrainë. Droni është rrëzuar pranë Gadishullit ukrainas të Krimës, të cilin Rusia e ka aneksuar ilegalisht në vitin 2014 dhe e ka shfrytëzuar vazhdimisht si bazë për nisjen e sulmeve ajrore në pjesën tjetër të Ukrainës. Lavrov ka thënë se fluturimi i dronit amerikan ka pasur për qëllim ta provokojë përshkallëzimin e situatës. "Kjo është keq, sepse ShBA-ja vazhdimisht ka thënë se është një fuqi e përgjegjshme, e interesuar për stabilitet strategjik", ka thënë Lavrov.

Nga koha e Luftës së Ftohtë, kjo duket se është hera e parë që një avion amerikan rrëzohet pasi goditet nga një avion ushtarak rus. Gjenerali i pensionuar i ushtrisë amerikane, Stephen Twitty, thotë për programin "Expose" të Radios Evropa e Lirë se ShBA-ja nuk duhet të lejojë që të provokohet nga rusët dhe të ndërmarrë ndonjë hap joracional. "Është një sjellje e rrezikshme dhe joprofessionale e Rusisë. Sa kam qenë zëvendëskomandant i Komandës Evropiane të ShBA-së kam dëgjuar për sjellje të tilla. Kjo është hera parë që dëgjoj për një avion që rrëzohet ashtu. Por, nuk duhet ta marrim si punë të kryer derisa nuk mblidhen të gjitha faktet. Zyrtarë të lartë ushtarë, përfshirë gjeneralin Mark Milley, kanë thënë se janë duke i rishikuar faktet për të kuptuar plotësisht se çfarë ka ndodhur. Por, absolutisht, sipas raportimeve fillestare, është një sjellje e rrezikshme, joprofessionale, e provokuar nga rusët", thotë Twitty.

Twitty, tanë bashkëpunëtor i Qendrës për Analizë të

Politikave Evropiane, thotë se incidenti nuk ka të bëjë vetëm me ShBA-në, por edhe me 29 aleatë të tjerë të NATO-s. Duhet të shkojmë në atë drejtum, që nuk eçon NATO-n ose ShBA-në në luftë, thotë ai. "Dhe, duhet të sigurohem se Rusia e kupton se kjo është hapësirë ajrore ndërkombëtare dhe në hapësirë ajrore ndërkombëtare, liria e navigimit, qoftë mbi det, qoftë në ajër, qoftë mbi Detin e Zi, është e hapur për çdo vend", thotë Twitty.

Në mars të vitit 2022 ushtria amerikane ka krijuar një kanal, të njohur si linja e shtensionimit, për të komunikuar direkt me ushtrinë ruse, me qëllim të shmangjes së keqkuptimeve ose kalkulimeve të gabuara në lidhje me luftën në Ukrainë. Megjithatë, disa thirrje, në disa momente kritike, kanë mbetur pa përgjigje nga ana e Moskës. Në nëntor të vitit të kaluar shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë amerikane, gjenerali Mark Milley, ka bërë përpjekje të flasë me homologun e tij rus për një shpërthim në Poloni, të shkaktuar nga raketat ruse, por nuk ia ka dalë. Pas incidentit të fundit, Milley, ashtu si edhe sekretari amerikan i Mbrotjes, Lloyd Austin, kanë kontaktuar me homologët e tyre rusë për t'i sqaruar rrëthanat.

Hal Kempfer, oficer i pensionuar i Korpusit të Marinës amerikane, thotë për "Exposenë" se veprimet agresive ruse, si ato të 14 marsit, mund të çojnë në përshkallëzim të situatës, qoftë edhe në mënyrë të paqëllimshme. "Ndjekja e dronit ka qenë një veprim shumë provokues i rusëve. Kjo, në vetvete, është një përshkallëzim. Derdhja e karburanteve mbi

dron është një përshkallëzim. Vendosja e një avioni Su-27 në një pozitë që mund të shkaktojë telashe, është një përshkallëzim i madh", thotë Kempfer.

Incidenti i ka kushtuar ShBA-së një dron që vlen 32 milionë dollarë dhe përbën disa nga teknologjiet më të avancuara të vëzhgimit. Tash çështja është se kush do të arrijë i pari t'i mbledhë rrënojat në Detin e Zi. Uashingtoni, qartazi, nuk do të ishte i lumtur nëse një teknologji e tillë e ndjeshme e vëzhgimit do të binte në duart e Rusisë. Por, gjenerali Kempfer thotë se mbledhja e rrënojave në raste të tilla është një operacion sfidues dhe varet nga disa faktorë - në çfarë thellësie gjenden ato, si është terreni nënëjor e të tjera. "Pra, nuk është diçka që mund të bëhet sa hap e mbyll sytë. Kërkon shumë punë për t'u bërë. Rusia ka marinë atje. Ajo mund të fillojë të vendosë patrulla pikërisht në zonën ku është rrëzuar avioni, duke bërë një lloj kërcënim. Kjo është shumë e mundur", thotë Kempfer.

Udhëheqës të vendeve të NATO-s, përfshirë presidentin e Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, kanë thënë se do ta ndihmojnë Ukrainën ta përballojë pushtimin rus "për aq kohë sa është e nevojshme". Dhe për këtë qëllim nuk ka shërbyer

vetëm armatimi që Perëndimi i ka nisur Kievit, por edhe sasia e madhe e inteligjencës, e mbledhur në kohë reale nga misionet vëzhguese.

Falë këtyre misioneve forcat ukrainase kanë marrë informacione për operacionet ushtarake ruse, për lëvizjen e anijeve në Detin e Zi, përlëshimin e raketave drejt caqeve

në Ukrainë e të tjera. Pra, Kievi është jashtëzakonisht i varur nga rrjedha e këtyre informacioneve si për mbrojtjen e infrastrukturës kritike ashtu edhe për planifikimin e operacioneve të veta sulmuese. Gjenerali Twitty shprehet i bindur se misionet e tillë vëzhguese do të vazhdojnë pavarësisht incidentit të fundit në Detin e Zi. "Kjo është hapësirë ndërkombëtare ajrore. Ne do të vazhdojmë ta përdorim atë hapësirë ajrore duke qenë se është mbi ujërat ndërkombëtarë. Rusia mendon se kontrollon Detin e Zi, por nuk është vërtetë", thotë Twitty.

Vendet operojnë në mënyra rutinore në hapësirat ajrore ndërkombëtare dhe në ujërat ndërkombëtarë, dhe asnjë vend nuk mund të pretendojë se ka kufizime në territorin jashtë kufirit të vet. Gjenerali Kempfer thotë se nga misionet e tillë vëzhguese përfitojnë siguria dhe mbrojtja. "Operacionet përmbledhjen e informacioneve të inteligjencës do të vazhdojnë. Sa më shumë që dimë se çfarë ndodh, aq më të mira janë vendimet, aq më të sigurta bëhen gjërat. Pra, sa më shumë që dimë, aq më të vogla janë gjasat për të gabuar. Kjo vlen për të dyja palët. Të gjithë duhet të dinë se çfarë po ndodh", thotë Kempfer.

Bashkëbiseduesit e REL-it thonë se incidenti është një rikujtues i tmerrshëm për rrezikun e konfrontimit direkt midis ShBA-së dhe Rúsise për shkak të Ukrainës. Incidenti i tillë i radhës mund të jetë vetëm çështje kohe, thonë ata. Paralajmërimin e bën të frikshëm fakti se të dyja vendet kanë mijëra koka bërthamore si armë të fundit.

# Mendimi i ri gjepolitik



Nga: Christopher COKER\*  
Përktheu: Ali PAJAZITI

Gjepolitika si term daton nga pjesa e fundit të shekullit XIX dhe e njëjtë vazhdon t'i ruajë parimet e veta. Së pari, zakonisht ekziston një armik dhe identiteti i tij nuk është i rëndësishëm për bindshmërinë e teorisë. Ai që është i rëndësishëm është fakti se gara duhet të jetë forcë motivuese e marrëdhënieve ndërkombëtare. E dyta, gjepolitika presupozon një "lexim" të gjografisë (të hartave) që është tepër determinist, madje edhe fatalist. Ajo presupozon një interes të vazhdueshëm: balanca e fuqisë, pra disa vende rriten apo fuqizohen e disa dobësohen. Për t'i dhënë kuptim historisë strategjike duhet ndërtuar një kornizë të madhe konceptuale: zakonisht rendi politik mbizotëruesh shpesh është fragjil dhe ka nevojë për mbështetje (shpesh përmes forcave ushtarake).

Gjepolitika kritike është shfaqur në vitet 1990 si kundërshtim ndaj asaj që mendohej se përbente një determinizëm të vrazhdë që qëndronte pas disave nga konfliktet më të dhunshme të shekullit. Pretendimi i saj nuk ishte i paarsyeshëm apo i palogjikshëm: një tejjvendosje e realiteteve politike në ato gjografike që lejon që këto realitete të supozojnë një peshë gjepolitike shpeshherë kallpe. Agjenda e saj zakonisht është radikalë ose e fryshtuar nga majtizmi, kurse eksponentët e saj refuzojnë me gjithë mend një

pjesë të mirë të mendimit që qëndron poshtë Luftës Globale kundër Terrorit (Global War on Terror, GWOT), përfshirë narrativat e saj të frikës apo rezikut. Për ata gjepografia është "hapësirë", për të cilën ata pretendojnë se është një konstruktion social. Ne jemi ajo që mendojmë se jemi, jo viktimi pasive e determinizmit gjepografik. Fuqitë e tokës dhe ato të detit nuk janë të paracaktura që ta gjenë njëra-tjetrën në konflikt; bile edhe identiteti i "bërthamës" dhe "periferisë", ose i "Veriut" dhe "Jugut", janë gjëra që ne i krijojmë, janë prodhime tonat. Siç ka argumentuar kritiku i madh letrar Northrop Frye në *Fearful Symmetry* (Simetri e frikshme), "qendra e realitetit është ajo ku dikush gjendet, kurse perimetri i saj është gjithë ajo që e kuptimëson imaginata jone".<sup>[1]</sup> C'e do që politikanët nuk janë kritikë letrarë dhe pak qeveri tregojnë rrëfime të tillë. Kina dhe Rusia, sikurse edhe Shtetet e Bashkuara, s'ë kundërshtojnë gjepolitikën, ato ende flasin për gjepolitikë dhe përderisa ato vazhdojnë të bëjnë një gjë të tillë, lufta do të jetë një mundësi e mbështetur nga elementi që gjithnjë i ka dhënë formë asaj: narrativa që ne përdorim.

Sidoqoftë, imaginata gjepolitike vazhdon të zhvillohet. Gjepolika kritike paraqet evidentim të kësaj – është edhe vazhdim edhe thyerje radikale e asaj që ka ikur; është edhe kritike edhe bashkëfajtore. Ajo na bën që të mos i shikojmë hartat, siç kemi vepruar, ngaqë përfaqësimet hapësinore të ndasive të njerëzimit, qofshin

reale apo të imagjinguara, dhe jo më pak të vërteta, që thjeshtë mos përfytyrohen. Por në të njëjtën kohë na nxit që t'i kufizojmë emocionet dhe dëshirat. Një libër i tillë është ai i Robert Kaplanit, *The Revenge Geography* (Hakmarrja e gjepografisë), që flet përritjen e një disipline të re, *sociografi*, që na ndihmon ta kuptojmë "gjepografinë e re urbane të përmallimit të thellë personal përmegaqytetet e së nesërmes (kështjellat e gjera të përpjekjes personale)".<sup>[2]</sup> Dhe hartat tonë të një malli të tillë mund të janë të detajuara po aq sa përshkrimet e vet qyteteve. Një veprë tjetër që ka të bëjë me peizazhin emocional është ajo e Dominique Moisiut, *The Geopolitics of Emotion* (Gjepolitika e emocioneve), në të cilën ai e ndan botën në dy grupe. Në të parin bëjnë pjesë shtetet e shpresës, si Kina dhe India, të cilat duan të kapin dhe ta kapërcejnë Perëndimin. Ato janë të interesuara për zhvillimin ekonomik, jo të menaxhimit të punëve globale. Ato shprehin pak interes, për shembull, për çështjen nëse shtete si Irani do të bëhen fuqi bërthamore, ndonëse janë të interesuara në çështjet e mijedisit ngaqë ndryshimet klimaterike kanë pasoja ekonomike. Grupi i dytë përfshin shtetet që ndihen të poshtëruara nga historia. Shumica prej tyre janë pjesë e botës islamë: ato ndihen të mërzitura, të inatosura për shkak të pafuqisë së vet publike dhe mjerimit privat për çka e fajesojnë Perëndimin. Në këtë kategori bën pjesë edhe Rusia e Putinit, që tanimë nuk është superfuqi, një vend i

vjetruar, i dalë mode dhe i pezmatuar. Dhe më pas, aty është Perëndimi që frikohet nga e ardhma – frikësuar nga shtetet me oreks sepse janë në proces të prodhimit masiv dhe parakalimit oftë tij (të Perëndimit); frikësohen, gjithashtu, edhe nga shtetet e zemëruara sepse ato mund të

mundet që armët e kësaj kategorie të bien në duart e aktorëve joshtëtëror si Hizbullahu. Rol i fesë në vendimmarrjen politike gjithashtu shtron pyetjen e racionalitetit. Vërtet, sfida reale mund të jetë emocional. Është dyja superfuqitë kryesisht kanë qenë status që kanë krijuar vetë sferat e tyre të influencës. Asnjëherë s'i kanë besuar njëratjetërsit, por nuk kanë pasur as arsyet ideologjike e as politike që ta eliminojnë tjetrin.

*Historia* e dhunës sektare në

botën arabe na sugeron se feja

nuk e pengon luftën bërthamore.

Vërtet, natyra apokaliptike e fesë

sugeron krejtësisht të

kundërtën. Gjëja më

shqetësuese, shkruan Ron

Rosenbaum, është mendimi

ynë apokaliptik. Me gjasë, ne

jemi një lloj i obsesionuar me

vetëshkatërimin, lloj që bëjmë

skenarë të vetëdjegies, të

përfundimit kataklizmik të sagës

njerëzore.<sup>[4]</sup> Marrë nga revista

"Akademia"

mundet që armët e kësaj kategorie të bien në duart e aktorëve joshtëtëror si Hizbullahu. Rol i fesë në vendimmarrjen politike gjithashtu shtron pyetjen e racionalitetit. Vërtet, sfida reale mund të jetë emocional. Është dyja superfuqitë kryesisht kanë qenë status që kanë krijuar vetë sferat e tyre të influencës. Asnjëherë s'i kanë besuar njëratjetërsit, por nuk kanë pasur as arsyet ideologjike e as politike që ta eliminojnë tjetrin.

*Historia* e dhunës sektare në

botën arabe na sugeron se feja

nuk e pengon luftën bërthamore.

Vërtet, natyra apokaliptike e fesë

sugeron krejtësisht të

kundërtën. Gjëja më

shqetësuese, shkruan Ron

Rosenbaum, është mendimi

ynë apokaliptik. Me gjasë, ne

jemi një lloj i obsesionuar me

vetëshkatërimin, lloj që bëjmë

skenarë të vetëdjegies, të

përfundimit kataklizmik të sagës

njerëzore.<sup>[4]</sup> Marrë nga revista

"Akademia"

\* Christopher Coker, *Can War be Eliminated, Polity, Cambridge, 2016, f. 62-67.* (Libër që së shpejti pritet të botohet shqip si A mund t° eliminohet luftang Logos-A Shkup.)

[1] Northrop Frye, *Fearful Symmetry: A Study of William Blake* (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1947), f. 264.

[2] Robert Kaplan, *The Revenge of Geography* (New York: Random House, 2012), f. 29.

[3] Dominique Moisi, *The Geopolitics of Emotion* (New York, Anchor, 2009).

[4] Ron Rosenbaum, *How the End Begins* (New York: Simon & Schuster, 2011).



## Gega vendos rekord të ri në Francë

LILLE, 19 MARS - Atletja shqiptare, Luiza Gega ka vendosur sot një rekord të ri kombëtar në garën e 5 km rrugë. Gega fiksoi kohën 15 minuta e 16 sekonda në

eventin prestigjioz "Semi Marathon" që u mbajt në Lille të Francës. Gega përmirësoi kohën e saj me 23 sekonda, pasi më herët në gjysmë maratonën e 5 kilometrave

shënonë 15:39. Për vetëm 2 sekonda, shqiptarja do kishte mundur të thyente edhe rekordin ballkanik të kësaj kategorie. Me kohën 15:16 Gega u rendit në vend të shtatë

në Lille, por vlen për t'u theksuar se ky rezultat ishte më i miri i arritur nga sportistet evropiane në një aktivitet që pa të konkurronin atletet më të mira të botës.



## Gabojnë Ballkani dhe Drita, fiton Prishtina

Ferizaj të dielën e ndali Ballkanin, derisa Llapi i Tahir Batatinës arriti të merr një pikë në Gjilan, kurse Trepça'89 arkëtoi pikët e plota në shtëpi. Të shtunën Prishtina e mposhti Drenicën, kurse Drita ndau pikët më Malishevën

PRISHTINË, 19 MARS - Tri ndeshjet në kuadër të xhiros së 26-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll që u zhvilluan të dielën sollën lojëra interesante dhe emocionuese. Kampioni në fuqi, Ballkani, pas eliminimit në çerekfinale të Kupës nga Prishtina, këtë fundjavë nuk arriti të nxjerrë më shumë se sa një pikë si mysafr ndaj Ferizajt (0-0). Kësosoj, pas kësaj jave portokallezintë e Suharekës mbesin në pozitën e dytë, me një pikë ngecje ndaj Dritës. Pa fitues u mbyll edhe përballje ndërmjet Gjilanit dhe Llapit, por këtu të dy skuadrat shënuan nga dy herë. Gjilani kaloi në epërsi qysh në minutën e 4-t, me golin e Dabiqajt. Mirëpo, reagimi i Llapit ishte i shpejtë,

pasi baraspeshën e vendosi Augusto, në minutën e 17-të me golin e shënuar nga gjaujtja e lirë. Vendasit arritën ta rikthejnë epërsinë në minutën e 61-të, me golin e Kelmendit, por llapjanët në minutat e fundit të ndeshjes barazuan sërisht, kësaj radhe me golin e Riverës. Ndërkohë, tri pikë tejet të rëndësishme në luftën përmbytjetë i arkëtoi Trepça'89, e cila në stadiumin "Riza Lushta" e mposhti Dukagjinin, me rezultat 2-1. Oyekanmi shënoi golin e parë përm Trepçën në minutën e 6-të, duke krijuar një epërsi të hershme përm skuadrën e tij. Në pjesën e dytë, Trepça vazhdoi të luante në një nivel të lartë dhe në minutën e 80-të, Muja shënoi golin e dytë. Dukagjini



nuk u dorëzua dhe shënoi gol në minutën e 84-t, me anë të Halitit, duke e bërë fundin e ndeshjes dramatik, por minutat e mbetur nuk i mjaftuan përm t'iu shmagur humbjes. Të tri ndeshjet filluan me një minutë heshtje në nderim të ish-futbollistik të njohur mitrovicas, Sadik Rrahmani, i cili ndërrroi jetë të dielën. Prishtina, e cila

javëve të fundit ishte në krizë të rezultateve ka arritur të shënoi fitore tejet të rëndësishme në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, në përballje me Drenicën, me rezultat 1-0. Ishte qendërmbrorësi Bujar Plana, i cili shënoi golin e vetëm në ndeshje, në minutën e 33-të. Në frymën e fundit të ndeshjes, Prishtina mbeti pa portierin

SUPERLIGA	
Gjilani - Llapi	2-2
Malisheva - Drita	0-0
Drenica - Prishtina	0-1
Trepça '89 - Dukagjini	2-1
Ferizaj - Ballkani	0-0

  

Tabela	
Pikë	
1. Drita	52
2. Ballkani	51
3. Gjilani	40
4. Prishtina	35
5. Llapi	33
6. Dukagjini	32
7. Malisheva	29
8. Trepça '89	29
9. Ferizaj	28
10. Drenica	23

Ardit Nika, i cili u përgashtua me karton të kuq dhe në portë u vendos futbollisti Mërgim Pefqeli, por Drenica nuk arriti të shënojë nga gjaujtja e lirë. Në ndeshjen tjetër skuadra e Dritës nuk arriti të fitojë ndaj Malishevës në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Liman Gegaj", pasi rezultati mbeti ai i fillimit, 0-0.

## Derbi i takon Pejës



MITROVICE, 19 MARS - Peja ka triumfuar në derbin e javës së 26-të, duke mundur Trepçën me shifrat 70:73 (23:18, 13:20, 16:25, 18:10). Çereku i parë ishte kryesishët i barabartë me vendasit që kishin epërsi të lehtë, ndërsa e fituan këtë pjesë 23:18. Megjithatë, pejanët kundërpërgjigjen shpejt, ku arritën të shkrjnë epërsinë dhe në pushim shkuan me dy pikë në favor të tyre, 36:38. Loja e mirë e "verdhezinje" vazhdoi në periodën e tretë, ku filluan shkëputjet në "Minatori",

ndërsa shifrat pas 30 minutash ishin 52:63. Vendasit luftuan deri në fund, por nuk arritën më shumë përvçe të afrojnë shifrat në 70:73, sa ishte rezultati përfundimtar i kësaj

sfide. Te vendasit u dallua Jamel Artis me 19 pikë e nëntë kërcime, kurse te mysafrët u dalluan Brad Waldow me 11 pikë e 20 kërcime dhe Arti Hajdari me 17 pikë. Trepça numëron 15 fitore e 11 humbje, kurse Peja 19 fitore e shtatë humbje. Golden Eagle Ylli ka triumfuar në Gjakovë ndaj Vëllaznimit me rezultat 75:89 (15:15, 18:32, 18:24, 24:18), në javën e 26-të të Prince Caffe Superligës. Vetëm çereku i parë ishte i barabartë, duke përfunduar 15:15, e më pas Ylli

filloj shkëputjen, ku ishte dukshëm më i mirë në periudhën e dytë, duke shkuar në pushim me shifrat 33:47. Therandasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e tretë, përm t'eu shkuar edhe më shumë epërsinë, ku rezultati pas 30 minutash ishte 51:71. Në dhjetë minutat e fundit nuk kishte ndonjë dallim të madh dhe Ylli fitoi 75:89. Më i miri te vendasit ishte Devi Johnson me 27 pikë, kurse te mysafrët u dalluan Chris Harris me 12 pikë e 19 kërcime dhe Ardit Pepaj me

16 pikë. Vëllaznimi tanë ka tetë fitore e 18 humbje, kurse Ylli 19 fitore e shtatë humbje. Ponte Prizreni ka shënuar fitore shumë të vlefshme në garën përm "play-off". Prizrenasit kanë mundur Rahovecin me rezultat 94:86 (23:27, 23:25, 23:18, 25:16). Më të mirët e prizrenasve ishin Urim Zenelaj me 20 pikë e 12 kërcime dhe Meriton Ismaili me 20, kurse te rahovecasit u dalluan Gary Blackstone me 16 pikë, 10 kërcime e shtatë asistime dhe Edmond Kryeziu me 21 pikë e katër kërcime.

## Barcelona fiton 'El Clasico'-n, titulli shumë afër



BARCELONA, 19 MARS - Barcelona "vret" garën përtitullin kampion në Spanjë, fitore e madhe e tyre 2-1 në "El Clasico" ndaj Real Madrid. Fati nuk do ishte me katalanasit në minutën e nëntë pasi Araujo do realizonte autogol. Ekipi i Xavit tentoi të vendosë ekilibrat me Christensen, por ky i fundit nuk ia doli dot. Në fundin e frakcionit, ai që do rikthente gjithçka nga

e para do ishte Roberto. Pjesa e dytë do ishte emocionuese dhe me mundësi shënimis. "Los Blancos" gjëzojnë pas golit të Asensios në minutën e 81-të, por më ket, pasi VAR e anulon përm "offside". Atëherë kur nuk pritej, në fund, Barcelona merr 3 pikë falë golit të Kessie. Kështu, Leëandoëski me shokë renditen në vendin e parë me 68 pikë, 12 pikë më shumë se ekipi i Ancelottit.

## Juventus fiton derbin ndaj Interit në 'San Siro'



TORINO, 19 MARS - Juventus është fitues i derbit të Italisë. Skuadra bardhezi mori një fitore të madhe 1-0 në "San Siro" duke konfirmuar formën mjaft të mirë që po kalon në këtë fazë të sezonit, edhe pse në fakt vinte me shumë mungesa. Pa Di Marian, Pogba-n dhe disa lojtarë të tjera, Allegri i beson të rinjve si Soule dhe Fagioli, me këtë të fundit që bëri një

paraqitje fantastike. Skuadra bardhezi do të kalonte në avantazh në minutën e 23-të me një gol të Kostic, i cili la të shtangur portierin Onana. Edhe pse pritej një reagim nga Interi, Juventus nuk lë hapësira dhe madje rrezikon në disa raste përm t'gjetur dhe skuadra torineze rezistoi të merrte 3 pikët e radhës.



The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a section titled "Quality & Sales Award Recipients" lists ten companies from various countries. To the right, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle.

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



The advertisement features a circular tin of Meka Halal Food Pashtetë Pule. The tin is orange with a silver lid. It shows a slice of pate with a red pepper and herbs. Text on the tin includes "MEKA HALAL FOOD", "PASHTETË PULE", "cili e garantuar", "pa konservues", "gluten free", and "100% mish pule". The background is orange with white abstract shapes.